



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 55/12

Prishtinë, më 28.03.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Bedri Hamza Ministër i Financave, Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga KDI, OSCE.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli, Kushtrim Aliu dhe Ardita Fejza (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit;**
3. **Raportim nga Ministri i Financave për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2011,**
4. **Shqyrtimi i Projektligji nr.04/L-062 për fshatin Hoçë e Madhe me Raportin me amendamente të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
5. **Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2013-2015;**
6. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja , konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit

Kryetarja, konstaton se procesverbalet e datës 9.03.2012 dhe 14.03.2012, miratohen njëzëri.

3. Raportim nga Ministri i Financave për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2011

Kryetarja, njoftoi anëtarët e komisionit që sipas planit të Kuvendit për Integritet Evropian për vitin 2011 dhe planit vjetor të komisionit, i'u është dërguar kërkesa Ministrisë së Financave për të raportuar për përmbushjen e obligimeve në tremujorin e parë për sfidat që kanë daluar nga raporti i progresit. Siç e keni të bashkangjitur, Ministri ka dërguar raportin dhe nga përgjigjet e marra në formën e shkruar shihet një progres i konsiderueshëm për çështjet të cilat janë ngritur në raportin e progresit dhe gatishmëria dhe planifikimi i Ministrisë për të ndërmarrë hapa konkret për përmisimin e gjendjes.

Bedri Hamza, raportoi se janë bërë përpjekje për adresimin e sfidave, problemeve, dobësive në sistemin tonë të identifikuar nga Raporti i Progresit, këto janë sfida dhe problem që nuk mund të eliminohen brenda një periudhe të shkurtër kohore. Është ngritur edhe çështja e inflacionit, pasi kemi theksuar se ne jemi ekonomi që varemi shumë nga importi, kryesisht ka qenë inflacion i importuar si është tek çmimi i derivatet e naftës dhe artikujve ushqimorë. Kemi pasur trend stabilizues muajt e fundit të vitit 2011 dhe muajt e parë të këtij viti dhe presim gjatë vitit 2012 të ardhshëm të kemi një rënie të inflacionit. Gjatë periudhës afatmesme të gjitha parashikimet tregojnë se do të kemi një inflacion rreth 1.2 deri në 1.7 %. Sfida e dytë ka qenë deficit buxhetor. Me rastin e aprovimit të buxhetit për vitin 2011 është projektuar një deficit më i lartë, mirëpo në marrëveshje me FMN kemi marrur masa strukturore në buxhet dhe në fund të vitit ka qenë deficit 1.8%. Për vitin aktual kemi marrë masa strukturore në pjesën e të hyrave dhe shpenzimeve dhe presim se në fund të vitit do të kemi një deficit më të ulët se ai i projektuar, më i ultë se 2%. Një vështirësi ka paraqitur privatizimi i PTK-së. Me marrëveshjen e re me FMN kemi arritur që procesin e privatizimit të PTK-së ta përjashtojmë nga marrëveshja dhe në fund të vitit 2012 kemi rënë dakord, duke përjashtuar privatizimin e PTK-së bilanci bankar do të jetë 187 milion euro. Këtë vit buxheti është aprovuar me një deficit brenda parametrave të pranueshëm. Nga buxhetin fillestar kemi vlerësuar që rezerva buxhetore e lirë për shpërndarjet të jetë 124 milion ndërsa në fund të raportit ka dalë mjete të lira për shpërndarje 160 milion nga 203 milion, dmth afërsisht 36 milion kemi pasur gjendjen më të mirë se sa është aprovuar në buxhet. Gjithashtu huazimet që janë 74 milion, kemi startuar me tregun e letrave me vlerë, deri tash kemi përmbyllur 3 ankande dhe është arritur një normë e interes mesatare prej 3.5 %, prandaj nuk ka vështirësi sa i përket 74 milion të huazimit të brendshëm. Pjesa tjetër ka të bëjë me përkrahjen direkte buxhetore prej 50 milion dollar nga marrëveshja e Bankës Botërore me FMN në qoftë se ne i plotësojmë kushtet. Deri me 1 gusht është paraparë rreth 46 milion përkrahje direkte buxhetore në formë të kredisë, dhe deri me 1 dhjetor pjesa tjetër. Për vitin 2013 është dizajnuar marrëveshja për një shumë simbolike rreth 12 milion euro. Nëse ndodh privatizimi i PTK-se bilanci bankar do ta kalojë mbi 400 milion euro. Për transparencë buxhetore të gjitha dokumentet do të publikohen në Web faqe. Sfidë tjetër ka qenë planifikimi fiskal dhe cilësia e financave publike. Ministria e Financave i ka kapacitetet më të ndërtuara në krahasim me ministrinë e lindjes sa i përket financave publike, më tepër do koncentrohemi në përmirësime në nivelin lokal. Sfida tjetra kanë qenë bashkëpunimi i doganës me institucione tjera siq është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sa i përket të drejtave të autorit kemi nënshkruar memorandumi të mirëkuptimit me doganat të zyrës për të drejtat e autorit. Sa i përket ligjit për shpërlarjes të parave kemi nënshkruar memorandumin duke zgjedhur drejtorin i cili ende nuk i ka fuqitë e plota dhe presim ligjin e amendamentuar të vij në Kuvend për shqyrtim. Këto kanë qenë disa nga sfidat e Raportit të Progresit.

Hykmete Bajrami, unë mendoj që transparenca buxhetore nuk bëhet vetëm me publikimin e dokumenteve por është edhe mënyra se si shkruhen dokumentet. Për shembull në ligjin e buxhetit në tabelat ka pengesa për me qenë transparent qind përqind. Ne kur kemi analizuar projektet kapitale e kemi pasur shumë të vështirë dhe është dashur të marrim projektbuxhetin e vitit 2011, dhe të marrim edhe ligjet tjera të buxheteve dhe me i shikuar tabelat edhe të disa viteve paraprake, në mënyrë që ti shohim se cilat janë projektet e reja dhe cilat janë në vazhdim. Ka pasur raste që për x shkolla dhe x rrugë kur kemi shikuar dokumentet e buxheteve paraprake ato është dashur të përfundojnë në vitin 2010, 2011 mirëpo i kemi pasur si projekte në vazhdim edhe në vitin 2012. Ne nuk e dimë se kur do të përfundojnë ato projekte. Do të thotë në strukturën e dokumenteve ka mundësi që të ndryshohet me shumë për të rritur transparencën.

Latif Gashi, problemi i cekur më parë nga deputetja Bajrami, mendoj që është problem edhe prej viteve të mëhershme, megjithatë mendoj që nuk mungon transparenca, sepse çdo herë nëse një projekt nuk ka mundur të kalohet ai është bartur në kornizat afatmesme të shpenzimeve. Nuk është çështja që ato probleme kanë ndodhur vetëm prej vitin 2010 apo 2011, por edhe më herët.

Sali Asllanaj, objektivisht ndoshta progresi nga Ministria e Financave nuk mund të izolohet, dhe shumë gjëra nuk varen vetëm nga Ministria e Financave por nga subjektet tjera të sektorëve tjerë të Qeverisë. Sa i përket transparencës gjithmonë ka hapësirë për shumë përmisime, mirëpo edhe kjo që kemi për momentin na ka shërbyer të kemi mjaft informata dhe të japim kontributi tonë në atë aspektin e mundësitë tona. Është një vërejtje në Raportin e Progresit lidhur me piraterinë. Mendoj që pak është bërë në atë drejtim sepse e drejta autoriale çdo kund në botë çmohet shumë, tek ne jo. Do të duhej që jo vetëm të nxjerrim ligje por të merremi më tepër me zbatimin e tyre.

Hasime Krasniqi, lidhur me gjithë këto informata të ofruara mund të shohim se janë hapa të arritshëm nga Qeveria e Kosovës, mirëpo do ta ketë mbështetjen tonë për ngritjen e kapaciteteve të larta dhe për përmirësimin e të gjitha kërkesave që ka bërë Raporti i Progresit aty ku mund, dijmë dhe të bëjmë një përmirësim të gjendjes reale. Lidhur me atë që ceki kolegja Hykmete për projektet kapitale të cilat janë paraparë të reja apo të vjetra edhe gjatë punimit të projekt buxhetit, drejtori i buxhetit e ka cekur që janë bërë ndërrimi i kodeve ekonomike se nuk dihej, a është projekt i ri apo projekt i vjetër dhe mendoj se që në kohë e kemi bërë këtë përmirësim.

Naser Osmani, të arriturat në Kosovë nuk janë vetëm përgjegjësi as e ministrit, as qeverisë por janë përgjegjësi e gjithë shoqërisë, edhe pozitës dhe opozitës. Në këtë relacion ka ndihmuar edhe kontributi dhe raportet e mira brenda komisionit. Sa i përket standardeve përshtatjes së legjislacionit, kemi raste që nganjëherë bëjmë ligje të cilat faktikisht na servohen dhe pas një kohe procedohen ligje të reja dhe thojn se kjo nuk ka qenë me standarde ndërkombëtare, psh. rasti i Ligjit të prokurimit. Unë konsideroj se në këtë fazë, vendi ka nevojë për një bashkërendim më të madhë sidomos në zhvillimin ekonomik. Çështja që u ngrit me komunat është më të drejtë, kemi raste ku komunat bëjnë projekte pa mbulesa financiare. Duhet shikuar çështjen e mundësive më të mira të zhvillimit ekonomik, siq është rasti i investimeve të partneritetet publiko-private. Ajo se qfarë desha të përmend, mendoj që edhe ju si ministër edhe Qeveria duhet të insistoj ta forcoj institucionin e entit statistikor si një burim i të dhënave të mira ku kishin mundur të shërbejnë në planifikime më të mira qoftë buxhetore, qoftë të kornizave tjera, për arsye se duhet të jetë një institucion i besueshëm i cili në bazë të sondazheve bënë hulumtime me të sakta mbi bazën e kësaj kemi edhe planifikime më të mira. Një çështje tjetër është ngarkesa e financimit prej buxhetit, do të thotë kemi një staf jashtëzakonisht të madh, kjo reflekton prej mungesës së ekonomisë së sektorit privat, mirëpo në ligjet e ardhshme do të duhej që mundësisht të mos kemi ngritje të institucioneve të reja sidomos agjencioneve që po krijojnë shpenzime. Sa i përket çështjes së ligjit për pagat e funksionarëve të lartë që

do të ishin edhe këto agjencione që po i përmendi që njëherë e përgjithmonë ta përmbyllin këtë laramanin në shpërblime dhe ta kishim vënë në sistem.

Albana Fetoshi, kam një pyetje për ministrin sa i përket Raportit të Progresit dhe mënyrës se si ne i miratojmë ligjet tash në fund e kemi ligjin për Fondet Pensionale dhe ligjin për bankat dhe aty në dispozitat përfundimtarë shënon që ky ligj hynë në fuqi me 30 mars, ndërkohë sipas kushtetutës që ligji është dashur të hyjë në fuqi 15 ditë pas publikimi në gazetën zyrtare. Është diskutuar edhe në komision mirëpo sa me kujtohet Naser Osmani ka thënë që ministri ka kërkuar që të jetë kjo datë, unë do të kisha dashur ndoshta një arsyetim ministër kush po e kërkon miratimin e përshpejtuar të ligjeve dhe cila është arsyeja e kërkesës për hyrjen kaq të shpejt të ligjeve në fuqi?

Bedri Hamza, theksoi se agjenda evropiane është agjendë që të gjithë e përkrahim, unë jam i sigurt që sfidat dhe problemet e vitit të kaluar, një pjesë e tyre nuk kanë me qenë pjesë e Raportit të Progresit të ardhshëm, ka me u vlerësuar progres në shumë fusha mirëpo të jemi real që ne nuk do ti përfundojmë të gjitha. Të dijmë që buxheti përveç që është dokument profesional, ndonjëherë është edhe dokument politik dhe duhet të akomodohen edhe politika të shprehet në numra. Sa i përket transparencës gjithmonë ka vend edhe për më shumë, duhet të punojmë në atë drejtim mirëpo një risi që e kemi futur dhe e kemi bërë si obligim ligjor është që më përveç këtij raportimit financiar që e kemi, ka filluar për herë të parë këtë vit , të kemi edhe raportimin për progresin fizik të projekteve dhe raportimin për vlerën për para. Kemi probleme me statistikën, janë identifikuar dhe janë pjesë e Raportit të Progresit. U përmend çështja e vendosjes së ligjeve për të hyrë në fuqi, unë kam kërkuar mendim juridik prej zyrës ligjore, prej njerëzve kompetent dhe shpjegimi i tyre ka qenë që ligji mund të hyjë në fuqi në pas aprovimit, kalimit të gjitha procedurave dhe shpalljes në gazetën zyrtare, dhe mund të hyjë në fuqi në momentin si përcaktohet në ligj. Tri janë veprime paraprake që ne si Kosovë ta fitojmë të drejtën që programi i Kosovës me FMN të shqyrtohet në prill është ligji për bankat, ligji për fondin pensional dhe është një vendim i cili është marrë në Qeveri për reduktimin e alokimeve deri në vlerë prej 20 milion euro.

Kryetarja, do të ndërlihdhesha me ligjin e ngritur për pagat e funksionarëve të lartë publik, kur e kemi miratuar buxhetin kam kërkuar në emër të komisionit që ky ligj ose të procedohet sa më shpejtë ose t'i lihen kompetencat Kuvendit që të mirret me hartimin e këtij projektligji. Por me qenë se, ka qenë në agjendën legjislativë të Qeverisë, dhe duke ditur se është përgjegjës një komisionit tjetër, se po të kishte qenë përgjegjëse komisioni jonë ndoshta edhe se kishim pritur Qeverinë, se vërtetë po kemi probleme me pagesën e pagave të funksionarëve publik, thirrjen e ligjeve të cilat nuk ekzistojnë të cilat kanë rënë prej fuqie dhe sa më shpejtë që të miratohet ky ligj na kish zgjedhë një problem që të mos bëjmë shkelje ligjore të më tutjeshme.

Bedri Hamza, theksoi se edhe ne po ballafaqohemi me këtë problem si rezultat i mungesë së Ligjit për pagat e funksionarëve publik. Është përparësi që ky ligj dhe ligjet që kanë të bëjnë me reformën e administratës publike sepse këtë vend në momente të caktuara ka për ta Mirëpo pa e ngritur nivelin e administratës publike, shërbimi civil ka për të pasur problem kush do që të jetë në pushtet për ti zhvilluar politikat e veta. Kërkesat janë që të zhvillohet sektori publik duke përfshirë edhe administratën publike. FMN është pajtuar pavarësisht se këto reforma kanë kosto shtesë që të ecët më këto reforma. Prej këtyre reformave përveç rregullores për klasifikimin e vendeve të punës është edhe ligji për pagat e shërbyesve të lartë publik. Ky ligj në raport me aktualen që e kemi tash nuk ka ndonjë kosto shtesë. Vlerësohet se kostoja e tij do të jetë rreth 1.6 milion. Ministria e Financave është e gatshme për ta dhënë deklaratën se institucionet financiare ndërkombëtare jemi në rregull dhe unë pres që sponzoruesit e këtij ligji, Ministria e Administratës Publike në një nga mbledhjet e ardhshme të Qeverisë ta procedon këtë ligj për aprovim në qeveri dhe pastaj të përcillet në Kuvend.

Kryetarja, theksoi se një çështje tjetër të cilën mendoj që do ta ngris edhe në Kuvend është çështja e marrëveshjes me FMN dhe gjatë këtij viti dhe fundvitit të kaluar kemi pasur probleme nga më të ndryshmet të cilat i kanë shkaktuar pikërisht komisionet funksionale të kuvendit duke i ngarkuar ligjet me kosto buxhetore. Për këtë çështje ne më GIZ kemi bërë një vlerësim të punës tonë dhe një vlerësim se çka është e nevojshme për Komisionin tonë dhe jemi dakorduar i gjithë komision që një përfaqësues nga Ministria e Financave të jetë i përhershëm në komision do të thotë për të gjitha pikat e rendit të ditës dhe kur ne kemi nevojë për ministrin me qenë prezent ta ftojme ministrin, prandaj mund ta bëjmë edhe një shkresë zyrtare që një person të caktohet nga ana juaj. Ne gjithashtu gjatë periudhës së ardhshme do ta bëjmë një monitorim të punës që e keni paraqitur këtu sidomos tek hapat e ardhshëm do të jemi në fokus të monitorimit se si po rrjedh situata që të kemi sa më pak vërejtje në Raportin e Progresit.

Bedri Hamza, në kërkesën e kryetares theksoi se e mirëpresim shkresën tuaj. Ne do të dërgojmë një person kompetent profesional të Ministrisë së Financave që do të jetë gjithmonë në dispozicion të komisionit. Sa i përket kostove të ligjeve ndonjëherë ka mospërputhje mes kostove që jep Ministria e Financave dhe deri sa shkon ligji në kabinet qeveritar ligji e ndërron koston.

Kryetarja, njoftoi se do t'i paraqesim në Raportin e Progresit të komisioni tjetër për Integritet Evropian dhe do të bëhen pjesë e vlerësimeve të tremujorit të parë i cili do të shkojë në Kuvend.

4. Shqyrtimi i Projektligji nr. 04/L-062 për fshatin Hoçë e Madhe me Raportin me amendamente të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja, ky projektligj me amendamente është shqyrtuar dhe e kemi kaluar. Kostoja për këtë projektligj ka qenë e përballueshme për Buxhetin e Kosovës në amandamentet e reja që kanë ardhur nuk e kanë ngarkuar në aspektin e koston projektligjin.

Jelena Bontic, theksoi se projektligji që për një kohë të gjatë ka qenë në komisione dhe po ndodhin shpesh ndryshime të gjitha amendamenteve dhe ka ardhur deri tek tri propozime. Propozimi i qeverisë, i Komisionit Funksional, dhe propozimi i deputetit Nait Hasani. Unë do të votoj kundër amendamentit nr.4, të tjerat amendamente do t'i mbështes.

Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2013-2015

Ismet Krasniqi, shkurtimisht prezantoi KASH-in e Kuvendit dhe njoftoi se karakteristika kryesore janë rritja e numrit të punëtorëve në administratë dhe punësimi i asistentëve të zyreve për deputete, hapja e zyreve rajonale dhe sistemi i IT-së. Kemi kërkesa nga grupi i grave deputete për mbulimin e aktiviteteve të tyre, që momentalisht jemi duke i paguar nga mallrat dhe shërbimet. Jemi në dilemë me projektin kapital Qendra Protokollare "Vila Gërmija", kur shifet mungesa e interesimit ndaj këtij objekti. Çështja tjetër është zbatimi i ligjit për shërbyesit civil që nënkupton pagesa për punën e kaluar dhe si rezultat i

vlerësimit dhe gradimit që mund të bëhen për zyrtar. Janë këto disa kërkesa ligjore dhe të arsyeshme, që mendojmë ti paraqesin në kohën e rishikimit të buxhetit dhe shpresojmë në përkrahjen e Komisionit. Sa i përket objektit të Kuvendit po kemi probleme pasi që objekti është i vjetër dhe kërkon investime të shumta të mirëmbajtjes. Kërkoj nga Komisioni ti rekomandohet Kryesisë për definimin e statusit të projektit “Vila Gërmija”.

Kryetarja, sa i përket projektit Vila Gërmija, është çështje e Kryesisë, përndryshe po të ishte objekt vendimi i komisionit, do të zgjidhte këtë problem. Kryesia do të duhej të merrej seriozisht me këtë problem dhe të zgjidhë atë. Sa i përket ndërtesës së Kuvendit, është e ditur se është i vjetër dhe kërkon investime, por ndonjëherë, po krijohet bindja se po me gjithë këto investime po e ndërtojnë një ndërtesë të re. Ndoshta duhet të shikojmë edhe shpenzimet mallra edhe shërbime, ndoshta është bërë furnizimi i stafit edhe deputetëve dhe ka mundësi me pas reduktime.

Latif Gashi, të gjithë jemi të njoftuar për problemet me buxhetin e Kuvendit dhe shkurtime që janë bërë, por realisht edhe atëherë edhe tani po thënë se ka qenë një pjesë e përgjegjësisë edhe e administratës së Kuvendit. Megjithatë mirëpres KASH-in, edhe pse ndoshta ka pak fryrje të buxhetit në disa pjesë. Sugjerimi im do të ishte që drejtori i buxhetit me kohë të marrë pjesë në dëgjimet buxhetore në Ministri, që mos të krijohen problemet që ministria me bë shkurtime të mëdha buxhetore, pastaj ne si komisioni të kemi telashe. Sa i përket projektit Vila Gërmija, mbështes mendimet e Kryetares, se është vendim krejtësisht politik dhe duhet vendos Kryesia.

Sali Asllanaj, lidhur me projektin për hapjen e zyreve regjionale për deputetë, theksoi se nuk e përkrah këtë ide, sepse konsideroj që nuk është në pajtim me sistemin zgjedhore që kemi aktualisht në Kosovë. Do të krijoheshin zyre jo funksionale dhe shpenzime të panevojshme dhe në këtë aspekt, e kisha lënë që të pritet reforma zgjedhore. Megjithatë ne presim që këtu në Kuvend, të na krijohen disa zyre në Kuvend që të krijohen kushte për punë dhe të përgatitemi për mbledhje.

Kryetarja, me qenë se është ligji për zgjedhje ne diskutime e sipër dhe nuk e dimë a do të jetë një zonë zgjedhore apo më shumë dhe kjo do të përcaktohet me ligj, por me qenë se po flasim për parashikimet afatmesme është mirë të lëmë siq është propozuar shtatë zyre si mundësi, që të mbetet si pozicion buxhetor, pastaj varësisht nga reforma zgjedhore mund të diskutohet dhe ndryshohet kjo çështje. Ajo çka do të doja është të kemi një komunikim më të madhë në mes administratës dhe Ministrisë, dhe në ato pozicione ku nuk ka asistencë nga ana Ministrisë, do të duhej të njihemi si komision dhe të analizojmë arsyeshmërinë e kërkesës së kuvendit qëndrimin e ministrisë për shkurtime të buxhetit. Duhet të jemi më shumë të informuar si po shkojnë procedurat me buxhetin e kuvendit, të ketë më shumë transparencë kur dihet se problemi i menaxhimit të buxhetit të Kuvendit është ngritur edhe si sfidë e Raportit të progresit.

Ismet Krasniqi, sa i përket Ministrisë të Financave, ata kërkojnë që ne të deklarojemi me shkurtime, por unë si sekretar mandej edhe bashkëpunëtorët e mijë nuk e kemi autoritetin të deklarojemi për shkurtime të buxhetit, kur buxheti dihet se buxheti i Kuvendit shqyrtohet në këtë komision dhe miratohet në Kryesi. Nga Ministria e Financave, me është thënë në mënyrë decizive se nëse nuk je bashkëpunues dhe nuk pranon shkurtime, mos eja.

Kryetarja, theksoi se në dëgjimet buxhetore të organizuara nga Ministria e Financave, përpos që duhet të marr pjesë administrata, komisioni duhet të njihet me orarin dhe do të caktojë një anëtarë nga pozita dhe një nga opozita të marr pjesë në dëgjim kur diskutohet buxheti i Kuvendit.

Sali Asllanaj, me që kemi të bëjmë me buxhetin e Kuvendit, ne duhet realisht të vlerësojmë nevojat për shpenzime dhe jo qeveria të përcaktojë buxhetin për kuvendin.

Kryetarja, njoftoi se në qdo vend përcaktohen kufijtë buxhetor, sepse për ndryshe nuk mundemi të hartojmë buxhetin, mirëpo ne duhet ta analizojmë arsyeshmërin edhe në bazë të vendosim. Është qartë e përcaktuar kompetenca e institucioneve që trajtojnë buxhetin, dhe Kuvendi është autoriteti i fundit, por duhet pasur parasysh arsyeshmërin para se të vendosim, të kemi më shumë informata bindëse për nevojat që kërkohen.

Hykmete Bajrami, theksoi se ne duhet e të mbështesim Kuvendin, dhe nuk mundemi të shikojmë si institucion të pavarur apo si agjencione të ndryshme që i ka themeluar Kuvendi, por duhet shikuar si pjesë mbështetëse e jona. Ne duhet mbështetur kërkesat e Kuvendit me qëllim të forcimit të administratës dhe kryerjes së punëve më kualitative. Duhet analizuar kërkesat e Kuvendit dhe nëse kërkohet më shumë se ofrohen shërbime për deputet, ne duhet të themi nuk jemi të kënaqur me shërbimet që ofron administrata dhe në këtë formë të arsyetohen kërkesat. Megjithatë duhet dhe ka nevojë për përmisimin e kushteve për punë për deputet, siq është rasti i zyreve. Duhet të krijohet komoditeti për të punuar, për të vendosur materialet dhe mos të bëjmë vetura. Me rastin e pjesëmarrjes së një anëtar të komisionit nga radhët e pozitës dhe opozitës në dëgjimet buxhetore në Ministrinë e Financave, duhet të këmbëngulim që të mos ketë shkurtime për Kuvendin.

Latif Gashi, theksoi se mendimet i kemi të njëjta por po i shprehim ndryshe. Realisht edhe unë jam dakord me pas buxhet Kuvendi dhe i parë e mora fjalën për të përkrahur këtë. Por qëllimi është që të përgatitet një buxhet të mirë, me kërkesa të arsyeshme buxhetore, me pjesëmarrjen e përgjegjësve në dëgjimet buxhetore dhe në arsyetimin e tyre.

Ismet Krasniqi, njoftoi se është bërë pranimi teknik i punimeve në aneksin e ndërtesës së Kuvendit, dhe në këtë fazë jemi duke bërë lëvizjen e deputetëve sipas grupeve parlamentare. E dyta është çështja e buxhetit të RTK, që e kemi vendosur pjesë të KASH-it dhe kërkesat e tyre i kemi vendosur siq na kanë ardhur.

Pas diskutimeve, Komisionit njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

- I. Të miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e Kuvendit të Kosovës për vitin 2013-2015 dhe t'i rekomandohet Ministrisë së Financave, që e njëjta të përfshihet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2013-2015.
- II. Komisioni për Buxhet dhe Financa, i rekomandon Kryesisë së Kuvendit, të merr një vendim përfundimtar për projektin kapital “Vila Gërmija”.

Mbledhja përfundoi: 12:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjonaj